



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit

01 Nr. ~~400-45870~~ Dt. 23 / 10 / 2020

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 17 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048, nenit 7 dhe 12 të Rregullores së MF - Nr. – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve dhe Rregullorës 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Kryetari i Komunës së Drenasit, më datën 23.10.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e Mirëqenjes e përkujdesjes Sociale, të cilat ofrojnë shërbime Sociale e Familjare të kategorive me kërkesa të veçanta.

I

1. Për implementimin e Thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF Nr. – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve dhe Rregullorën 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

2. Mbështetja publike për projektet/ programet e organizatave joqeveritare dhe personave fizik do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Drenasit - DSHMS, nga Kodi ekonomik për Subvencione 22/611/73010/21200/00000/0760

II

Mjetet Financiare te ndara për Subvencione nga pika I e këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të Thirrjes publike për ato projekte, që pas procedurës së konkurrencës do të shpallen si fitues të përgjegjshëm.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes, sipas pikes II të këtij vendimi, përfshinë:

- 1.1 Teksti i thirrjes publike
- 1.2 Udhëzimet për aplikantët
- 1.3 Formularët e aplikimit
- 1.4 Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
- 1.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1 Formularin e përshkrimit të programit ose projektit (F1)
- 2.2 Formularin e buxhetit të programit ose projektit (F2)
- 2.3 Formularin e deklaramentit të mungesës së financimit të dyfishtë të aktiviteteve nga një burim tjetër(F3)
- 2.4 Deklaratën e partneritetit (nëse zbatohet-F4)
- 2.5 Formularin e deklaramentit të programeve dhe projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (F5)
- 2.6 Deklaratën për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin (F6)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 3.1 Forma e kontratës për financimin e programit / projektit
- 3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin(F7)
- 3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit (F8)

IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në web faqen e Komunës së Drenasit komuna.drenas@rks-gov.net

V

- 1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të, Komuna e Drenasit do ta themelojë Komisionin vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

VI

- 2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit.

VII

- 3. Anëtarët e Komisionit vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren MF-nr.04/2017 për financimin publik të OJQ-ve dhe Rregullorës 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

VIII

- 1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve ose të personave fizik.
- 2. Komuna e Drenasit do të njoftojë përfituesin për kohën e nënshkrimit të kontratës.
- 3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IX

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij nga Kryetari i komunës.

Vendimi i dërgohet:

- 1. DSHMS-së,
- 2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- 3. Zyrë së Kryetarit,
- 4. Arkivës.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci